

Dokumente e politikave

Historitë e publikuara hulumtuese nga ana e re-grantistëve aktualizojnë çështjet e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, që prekin politika të caktuara publike. Për disa nga këto probleme, Qendra e menaxhimit me ndryshime dhe Instituti i të drejtave të njeriut, janë duke përgatitur dokumente për politika, me interes për publikun profesional dhe të gjerë.



Qendra e menaxhimit me ndryshime (QMN)
rr. „Rajko Zhinzifov“ 44/1, 1000 Shkup
tel. fax: (+389) 02 6092-216
e-mail: info@cup.org.mk
faqja e internetit: www.cup.org.mk

Instituti për të drejtat e njeriut (IDNj)
rr. „Rajko Zhinzifov“ 49A 1000 Shkup
tel. (+389) 2 3243 331
e-mail: ihr@ihr.org.mk
faqja e internetit: www.ihr.org.mk



Проектот е финансиран од Европската унија,
а кофинансиран од Британската амбасада Скопје

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit „Gazetaria hulumtuese, gardian i demokracisë dhe të drejtave të njeriut“, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike në Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet, si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Britanike në Shkup.



Проектот е финансиран од Европската унија,
а кофинансиран од Британската амбасада Скопје



GAZETARIA HULUMTUESE - GARDIAN I DEMOKRACISË DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

1 janar 2016 - 31 dhjetor 2017
Buxheti i projektit: 289,064.35 euro

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike në Shkup dhe implementuar nga organizata Qendra për menaxhim me ndryshime (QMN) dhe Instituti për të drejtat e njeriut (IDNj). Bashkëpunëtor mediatik në projekt janë TV Telma, uebportali Nova TV dhe javorja Fokus.

Imperativi kryesor i projektit

Në çfarë mënyrë gazetaria hulumtuese i mbron demokracinë dhe të drejtat e njeriut? Si, ky rol mund ti forcojë dhe ti thellojë më tej këto vlera? Si të rritet kontributi i organizatave civile në procesin e krijimit të politikave në raport me lirinë e mediave?

Vizioni ynë perfshin media dhe organizata civile të forta, të pavarur dhe aktive. Vend qendror në të kanë liria e shprehjes dhe integriteti mediatik si një element kyç në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

Ne besojmë se gazetaria cilësore hulumtuese është me interes jetik për qytetarët, sepse është një nga instrumentet, që më së shumti i mbrojnë të drejtat e njeriut. Historitë hulumtuese e monitorojë nga afër çdo abuzim të mundshëm të pushtetit, paralajmërojnë dhe tregojnë praktika negative në institucione, zbulojnë indikacione për abuzimet e mundshme të pushtetit dhe i promovojë interesat e disa prej komuniteteve më të cënueshme.

Ne besojmë se është e domosdoshme të forcohen kapacitetet edhe të organizatave civile, që punojnë në sferën e mediave dhe e mbështesin lirinë e shprehjes. Roli i tyre më i theksuar në arritjen e këtyre objektivave e inkurajojmë me krijimin e një platforme aktive për dialog dhe bashkëpunim të ndërsjellë mes organizatave civile dhe mediave.

Çfarë arritëm me projektin? Cilat janë rezultatet tona?

Disa nga gazetarët hulumtues më të njohur dhe më të shquar në Maqedoni, me mbështetjen tonë, e ndanë përvojën dhe njohurinë e tyre me më shumë se 150 studentë të gazetarisë nga Universiteti Kirili dhe Metodi, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti Goce Dellçev, në Shtip.

Për të mbështetur gazetarët e rinj - hulumtues dhe studentët e gazetarisë kemi organizuar dhe realizuar një kurs dy-mujor në gazetarë hulumtues, në fushën e të drejtave të njeriut dhe jurisprudencës.

Njëmbëdhjetë studentët më të mirë u shpërblyen me certifikata, por sigurisht kënaqësi më të madhe paraqet fakti se 4 studentë u punësuan pas përfundimit të kursit në disa prej shtëpive mediatike - bashkëpunëtorë në këtë projekt.

Shtatë studentë ishin praktikantë në mediat - partnere në projekt, TV Telma, Nova TV dhe Fokus, ku punuan nën udhëheqjen e gazetarëve hulumtues me përvojë. Mundësia, që nga afër të ndiejnë dhe të marrin pjesë në procesin e përditshëm të punës në mediat e llojeve të ndryshme (televizion, ueb-portal, javore), sigurisht se është shumë e rëndësishme për çdo gazetar të ri.

Duke besuar se përvoja praktike është e rëndësishme për gazetarët, kemi kryer trajnime dy ditore për gazetarët e rinj, për zhvillimin dhe promovimin e standardeve profesionale dhe integritetin mediatik, me gazetar të njohur nga rajoni, si nga Maqedonia, Sllovenia, Kroacia dhe Rumania.

Më i rëndësishëm është fakti, se kjo ju mundëson gazetarëve të njihen me kushtet dhe praktikën e hulumtimeve gazetareske në tre shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Studentët që ishin pjesë e kursit për gazetarë hulumtues përpunuan histori të tyre autoriale, për të cilat tre më interesantet kemi përgatitur edhe video të shkurtra.

Për nevojat e studentëve dhe gazetarëve përpunam edhe dy manuale:

- Manuali mbi lirinë e shprehjes - aspektet ligjore
- Manual për gazetarë hulumtues dhe qasje në informata

Njëkohësisht, si një produkt i hulumtimit në terren dhe analizës të thel kemi përgatitur edhe dy analiza.

- Ushtimi i së drejtës së lirisë së shprehjes - teoria dhe praktika
- Perceptimi i qytetarëve për mediat dhe profesionalizmi në mesin e gazetarëve

Manualet janë të një rëndësie të madhe për studentët e gazetarisë dhe gazetarëve të rinj që nëpërmjet tyre të njihen me aspektet teorike dhe ligjore të gazetarisë hulumtuese dhe lirinë e shprehjes.

Në të njëjtën kohë, analizat ofrojnë njohuri të rëndësishme mbi atë çfarë mendojnë qytetarët për punën e mediave, por edhe si vetë gazetarët i perceptojnë kushtet e ofruara nga fusha e mediave në Republikën e Maqedonisë, në aspektin e gazetarisë hulumtuese, standardet profesionale dhe parimet etike.

Këto histori atraktive, analizat dhe manualet mund ti shkarkoni nga:

www.istrarifakti.mk



Hulumto faktet - Një platformë për dialog dhe bashkëpunim ndërmjet organizatave civile dhe mediave, për gazetarë hulumtues

Një nga rezultatet më të rëndësishme të projektit është Platforma e themeluar për bashkëpunim të organizatave civile (përmes programit të ri-granteve) dhe organizatave të mediave, në bazë të së cilës në mënyrë aktive promovohet gazetaria hulumtuese, duke punuar me standardet më të larta profesionale dhe të etikës gazetareske.

Platforma është mbështetur nga ueb faqja www.istrarifakti.mk.

E veçanta e platformës është që organizatat civile dhe mediat bashkëpunojnë në histori hulumtues, në interes të promovimit të demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kështu, ata ndajnë përvojat dhe mësojnë nga njëri-tjetri.

Rezultatet nga programi për ri-grantim

Tetë projekte financuar përmes projektit në kornizat të ri-grantimit. Organizatat civile kanë zbatuar me sukses këto projekte në bashkëpunim me organizatat e mediave.

Rezultat i projekteve, janë histori të shumta hulumtuese në formën e intervistave, historive të shtypura dhe video.

Ylli i 6-të

Projekti: "Historitë e pa-treguara- Ekip i veçantë për promovimin mediatik, të nismave civile, për mbrojtje të të drejtave të komuniteteve të marginalizuara".

Janë publikuar 28 histori në portalin "Sakam da kazam" (Dua të them) (SDK.mk), që raportojnë për mbrojtjen dhe shkeljen e të drejtave njerëzore të grupeve të marginalizuara.

Ishte e organizuar edhe Foto ekspozitë me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me sindromën Daun.

Diverziteti media

Projekti: "Liria e shprehjes përmes gazetarisë hulumtuese". Në televizionin kombëtar Alsat-M në emisionin "Hulumtues në aksion" u transmetuan 18 intervista televizive rreth gjendjen e mediave, lirinë e shprehjes dhe gjyqësis, që janë reflektim i nivelit të demokracisë në shoqëri.

Në bazë të intervistave, janë publikuar dy histori hulumtuese në temat e njëjta.

Sheshi Liria

Projekti: "Gjyqësia - gardian ose shkelës i të drejtave të njeriut?". Janë publikuar 3 histori hulumtuese në javoren Fokus, ku tregohen qartë shkeljet e të drejtave të njeriut nga gjykatat, në mënyrë më specifike e drejta e romëve, për të udhëtuar jashtë vendit, të drejtat e punonjësve dhe e drejta e kujdesit social, të cilat nuk janë mbrojtur nga autoritetet gjyqësore për shkak të presioneve politike.

Citadela 16

Projekti: "Vështrim në ndërtimin e infrastrukturës rrugore." Në revistën javore Fokus, janë publikuar 3 histori hulumtuese, që zbulojnë aspekte të abuzimit të mundshëm të veprimtarisë zyrtare në zbatimin e tenderëve, për ndërtimin e tre seksioneve të autostradës në Maqedoni.

Qendra për Gazetarë Hulumtues- SKUP-Maqedoni

Projekti: "Mbrojtja e të drejtave përmes gazetarisë hulumtuese" SKUP, publikoi 3 histori hulumtuese, rreth atë se si në përqindje të madhe përdoren paditë për fyerje dhe shpifje nga ana e politikanëve për presion dhe frikësim të gazetarëve, por edhe të qytetarëve.

Metamorfozis

Projekti: "Kush ua lidh duart gazetarëve dhe si të zgjidhen ato?" - Fondacioni Metamorfozis, ka përpunuar një seri prej 3 video kontributeve të shkurtra, për përdorimin e tepruar të masës së paraburgimit, si një mjet i frikësimit të gazetarëve.

Qendra për zhvillimin e mediave të bashkësive

Projekti: "Lajmet i Anti-Korrupsionit i Mediave Lokale". Janë prodhuar tre histori investigative për dyshime për korrupsionin e qeverisë lokale, të cilat janë transmetuar në disa televizione rajonale dhe lokale

Shoqata për taktikë kreative

Projekti: "Blogje dhe rrjete sociale si një mjet dhe platformë për gazetarinë hulumtuese në fushën e jurisprudencës dhe të drejtave të njeriut."

Janë publikuar 5 histori hulumtuese, në temë drejtave individuale kundrejt atyre kolektive, tre prej të cilave në formën e blogjeve nga blogerë individual me ndihmën e gazetarëve hulumtues me eksperiencë nga Nova TV.

